



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2018:014997
Datë: 14.06.2018
Numri i dokumentit: 00061878

P.nr.145/17

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE PRIZREN-DEGA NË SUHAREKË- Gjyqtari Qemail Suka si gjyqtar i vetëm gjykues, me pjesëmarrjen e procesmbajtëses Vjollca Haziraj, në lëndën penale ndaj të akuzuarve Q. F. nga fshati R. Komuna Suharekë i akuzuar për veprat penale, përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 375 par. 2 i KP-së, veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par. 1 i KP-së dhe veprës penale lëndimi i lehtë trupor nga neni 188 par. 2 lidhur me par. 1 nën. par. 1.4 të KP-së, të akuzuarit M. F. nga fshati R. Komuna Suharekë i akuzuar për veprën penale lëndimi i lehtë trupor nga neni 188 par. 2 lidhur me par. 1 nën. Par. 1.4 i KP-së sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prizren PP.nr.311-3/17 dt.28.02.2017, pas gjykimit publik në prezencën e të akuzuarit Q. F. dhe mbrojtësit të tij av. R. H. nga Prizreni, të akuzuarit M. F. dhe mbrojtësi i tij av. N. H. nga Suhareka, me datën 18.05.2018 ka shpallur dhe me datën 31.05.2018 përpiloi me shkrim këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari Q. F., nga i ati G. dhe ëma H., të vajzërisë G., i lindur më 24.04.1959, në fshatin R., Komuna e Suharekës, ku edhe tani jeton, i martuar, babi i shtatë fëmijëve, invalid, ka të kryer shkollën fillore, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i R. së Kosovës, ka qenë në paraburgim nga data 09.02.2017 deri me datë 07.03.2017 dhe në arrest shtëpiak prej datës 07.03.2017 deri më datë 03.04.2018.

ËSHTË FAJTOR

- I. Sepse me datën 09.02.2017 rreth orës 15:30 minuta, në fshatin R. Komuna Suharekë, pikërisht në oborrin e të dëmtuarit M. F., përdorë armën në mënyrë kërcënuese ose frikësuese, në atë mënyrë që shkon në oborrin e të dëmtuarit, fillon të fjaloset për shkak të një kontesti pronësor, e më pas nxjerrë armën e zjarrit- pistoletën e markës G. prodhim italian 6.35 mm me numër serik P, me të cilën gjuan një herë në ajër, me qëllim të frikësimit dhe kërcënimit të dëmtuarit.

Me këto veprime ka kryer veprën penale përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 375 par 2 i KP-së.

- II. Sepse me datë 09.02.2017 ne fshatin R., Komuna e Suharekës përkatësisht në shtëpinë e tij familjare gjate një kontrolli dhe bastisje te policisë, është hasur duke mbajtur në posedim të paautorizuar armën e zjarrit –një pushkë gjuetie te markës S. P., lord prodhimi P/N. Kal.-12 Ga me numër serik P....., të cilat i mbante pa autorizim dhe leje te organit kompetent.

Me këto ka kryer veprën penale mbajtja në pronësi. Kontroll ose posedim të pa autorizuar të armëve nga neni 374 par1 i KP-së.

- III. Me datën 09,02,2017 rreth orës 15:30 minuta ne fshatin R., Komuna Suharekë i shkakton lëndime te lehta trupore te dëmtuarit M. F. vellaut te tije, ne atë mënyre që për shkak te mosmarrëveshjes te përshkruar si ne dispozitivin e pare e godet me një shtagë mjet ky i përshtatshëm për shkaktimin e lëndimit te rende trupo, ne pjese te ndryshme te trupit duke i shkaktuar lëndime te lehta trupore dhe ate: ndrydhje(bretje) të indeve te buta te kokës, dërmishje dhe gërvishje lëkurore të shuplakave dhe te dy duarve, plage qarëse shqyese te indeve te buta të regjionit muror te anës se djathë te kokës, gishtit te tret (gishti i mesëm) te shuplakës se dorës se djathte dhe te regjionit te bylyzikut te dorës se majte.

Me këto veprime ka kryer veprën penale lëndim i lehte trupor nga neni 188 par.2 lidhur me par.1 nën par.1.4 i KP-së.

Gjykata të njëjtit për veprën penale:

- përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 375 par. 2 i KP-së

I shqipton dënim me gjobë në Shumen prej 1000 (njëmijë) euro dhe dënim me burgim në kohëzgjatje prej një (1) viti i cili dënim nuk do të ekzekutohet ne afatin e verifikimit prej 2 vite nëse i akuzuari nuk kryen vepra tjera penale.

- mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par. 1 i KP-së.

I shqipton dënim me gjobë në Shumen prej 1000 euro i cili dënim do të ekzekutohet ne afatin prej 15 dite pas plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi.

- veprës penale lëndimi i lehtë trupor nga neni 188 par. 2 lidhur me par. 1 nën, par. 1.4. të KP-së.

I shqipton dënim me burgim në kohëzgjatje prej 6 muaj i cili dënim nuk do të ekzekutohet ne afatin e verifikimit prej dy viteve nëse i akuzuari nuk kryen vepra tjera penale, pas plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi.

Gjykata i shqipton dënim plotësues ne kuptim te nenit 374 par.3, i konfiskohet arma e zjarrit-një pushkë gjuetie e markës S. P., lord prodhimi P/N. kal- 12 me numër serik, 7 fishek të kalibrit 12 GA, pistoleta e markës G. prodhim Italian 6.35 mm me numër serik P.....

Obligohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve gjyqësore të procedurës penale për ekspertizën mjeko-ligjore ne shumen prej 20 euro, paushall gjyqësor të paguaj shumën prej 20 euro si dhe emër te fondit të viktimave në shumën prej 30 euro.

Gjykata në kuptim të nenit 80 të akuzuarit Q. F. i shqipton:

**DËNIM UNIK
DËNIM ME BURGIM DHE ME GJOBË**

Për veprat penale të përshkruara si më lartë të njëjtit i shqipton dënim unik me burgim në kohëzgjatje 1 viti e 4 muaj ne te cilin dënim do ti llogaritet koha e kaluar ne paraburgim dhe arrest shtëpiak prej 52 ditësh, cili dënim nuk do të ekzekutohet ne afatin e verifikimit prej 2 vite nëse i akuzuari nuk kryen vepra tjera penale, dhe dënim me gjobë 2000 euro të cilën duhet ta paguaj në afatin prej 30 dite.

I akuzuari M. F., nga i ati G. dhe ëma H., të vajzërisë G., i lindur më 17.03.1949, në fshatin R., Komuna e Suharekës, ku edhe tani jeton, i martuar, pensionit, i martuar, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i R. Së Kosovës, ka qenë në arrest shtëpiak prej datës 09.02.2017 deri më datë 11.03.2018.

ËSHTË FAJTOR

Sepse me datë, kohë, vend dhe mënyre te përshkruar si ne diapozitivin e trete te aktakuzës, me mjet te fort-shati e godet te dëmtuarin Q. F.-vellaun e tije, ne pjesë te ndryshme te trupit duke i shkaktuar lëndime te lehta trupore dhe atë: ndrydhje (brejtje) te indeve te buta te kokës, gishtit te trete, te shuplakës se dorës djathte, gjakmbledhje nen lëkur te vetullës se fytyrës, plagë qarëse- shqyese indeve te buta te regjionit ballor te nenës se djatht muroro-zverkor te kokës.

Me këto veprime ka kryer veprën penale lëndim i lehte trupor nga neni 188 par.2 lidhur me par.1 nën par.1.4 i KP-së.

Konform dispozitave ligjore ne fuqi te akuzuarit M. F. i shqipton:

DENIM ME BURGIM ME KUSHT

Dënim me burgim në kohëzgjatje prej 3 muaj në të cilin dënim do ti llogaritet koha e kaluar ne paraburgim prej 30 ditësh i cili dënim nuk do të ekzekutohet ne afatin e verifikimit prej 1 viti nëse i akuzuari nuk kryen vepra tjera penale

Obligohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve të procedurës penale për ekspertizën mjeko-ligjore ne shumen prej 20 euro, paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 euro si dhe emër te kompensimit të viktimave të krimit shumën prej 30 euro ne afat prej 30 dite pas plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi.

ARSYETIM

Prokuroria Themelore në Prizren-departamenti i përgjithshëm ka ngritur aktakuzën me numër PP/II.nr./311-3/17 date 28.02.2017, me te cilën ka akuzuar Q. F. nga fshati R., Komuna Suharekë i akuzuar për veprat penale, përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 375 par. 2 i KP-së, veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par. 1 i KP-së dhe veprës penale lëndimi i lehtë trupor nga neni 188 par. 2 lidhur me par. 1 nën. Par. 1.4 të KP-së, dhe M. F. nga fshati R., Komuna Suharekë i akuzuar për veprën penale lëndimi i lehtë trupor nga neni 188 par. 2 lidhur me par. 1 nën. par. 1.4 i KP-së.

Gjykata duke vepruar sipas aktakuzës ka mbajtur shqyrtimin gjyqësor pasi që te akuzuarit në shqyrtim fillestar dhe shqyrtim të dyte nuk e kanë pranuar fajësinë, ndërsa në shqyrtim gjyqësor e kanë pranuar në tërësi fajësinë për çka edhe gjykata me aktvendim e ka aprovuar.

Pranimi i fajësisë nga e te akuzuarve është bërë në mënyrë vullnetare pa presion, i mbështetur ne provat e lendes penale, gjykata përveç pranimit te fajësisë nga ana e te akuzuarve, fajësinë e te akuzuarve e bazon edhe ne provat që gjinden ne shkresat e lendes dhe atë: Kallezimit penal 2017-GB-... datës 10.02.2017 dhe shkresave tjera përcjellëse lidhur me bastisjen e shtëpisë se te akuzuarit Q. F., shiqimi i nje pushke gjuetie Mod. S. P., me numër serik te kal.12 ga, dhe nje pistolete e mdoelit G. prodhim italian kal.6.35 mm, mendimi i ekspertit mjeko-ligjor Dr. F. D., dt.24.02.2017, nga deklarata e te dëmtuarve/akuzuarve, nga angazhimi i ekspertit te Balistikes si dhe shkresat tjera te lendes.

Gjykata ne shqyrtimin e sotëm dhe me vet pranimin nga ana e te akuzuarve ka vërtetuar këtë gjendje faktike si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Këtë gjendje faktike gjykata e ka vërtetuar nga vet pranimi i te akuzuarve të cilët ne shqyrtimin fillestar e kanë pranuar fajësinë.

Gjykata sipas detyrës zyrtare konform nenit 257 te KPP-së ne shkresat e lendes nuk ka gjetur ndonjë prove te pa pranueshme dhe po ashtu gjykata ka vërtetuar se të akuzuarit, e kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit te fajësisë, pranimi i fajit nga ana e te akuzuarve, është bere vullnetarisht ne shqyrtimin gjyqësor, pranimi është mbështetur ne faktet e çështjes qe përmban aktakuza, te cilat gjinden ne shkresat e lendes si dhe provat materiale te paraqitura ndaj te akuzuarve nga ana e PTH-së ne Prizren.

Gjykata po ashtu ne tërësi ka ardhur ne përfundim se pranimi i fajësisë ne shqyrtim gjyqësor nga ana e te akuzuarve, është bërë ne pajtim me dispozitat e nenit 248 te KPP-së, nga se nuk ekziston ndonjë nga arsyet dhe kushtet për hudhjen e aktakuzës, apo pushimin e procedurës penale.

Nga këto fakte te cilat i përmban aktakuza, Gjykata ka ardhur ne përfundim se me veprimet e te akuzuarve formohen te gjitha elementet e veprës penale, përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 375 par. 2 i KP-së, veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par. 1 i KP-së dhe veprës penale lëndimi i lehtë trupor nga neni 188 par. 2 lidhur me par. 1 nën. Par. 1.4 të KP-së, për te akuzuarin Q. F. dhe veprën penale lëndimi i lehtë trupor nga neni 188 paragrafi 2 lidhur me paragrafi 1 nën. Par. 1.4 i KP-së për të akuzuarin M. F..

andaj Gjykata ka vendosur te akuzuarit ti shpall fajtor dhe t'iu shqiptoi dënimin si ne dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata te akuzuarit Q. F. ia ka shqiptuar dënimin plotësues, konfiskimin e armës së zjarrit- një pushkë gjuetie e markës S. P. lord prodhimi P/N. kal- 12 me numër serik, 7 fishek të kalibrit 12 GA, pistoleta e markës G. prodhim Italian 6.35 mm me numër serik P.....,

sepse me te njëjtat i akuzuari i ka poseduar dhe i ka përdorur para sulmit qe ia ka bere te dëmtuarit M. F..

Gjykata gjate marrjes se vendimit mbi dënimin ka vlerësuar te gjitha rrethanat ne kuptim te nenit 73 te KP-ës, te cilat ndikojnë ne lartësinë e dënimit.

Gjykata si rrethane lehtësuese mori për baze se te akuzuarit kane pasur qëndrim korrekt ndaj Gjykatës, ka bere pranimin e fajësisë ne mënyrë vullnetar, rrethana posaçërisht renduese nuk gjeti.

Vendimi mbi kërkesën pasurore juridike e mori ne kuptim te nenit 463 te KPP-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës e mori ne kuptim te nenit 452 par. 1 te KPP-së.

GJYKATA THEMELORE PRIZREN – DEGA NË SUHAREKE

Gj y q t a r i
Qemail Suka

KESHILLE JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 dite, nga dita e marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtine, përmes kësaj Gjykate.